



Trajneri i kombetares shqiptare vazhdon te jete ne gjurmim te talenteve shqiptare qe luajne jashte vendit. Pas disa emrash dhe afrimesh ne skuadren kuqezi De Biazi ka treguar interes dhe per 23 vjecarin Agron Mehmeti i cili aktualisht luan ne kampionatin portugez me Olhanensen. Sulmuesi me origjine shqiptare ka marre ftesen nga kombetarja shqiptare per te qene pjese e formacionit te De Biazit ne ndeshjet kunder Islandes dhe Sllovenise. Ne ditet ne vijim priten zhvillime te reja lidhur me vendimin qe do te marre Mehmeti.